

Të nderuara familje:

Po ju kontaktojmë për t'ju informuar në lidhje me një ndërprerje të mundshme të shërbimit të autobusëve të verdhë duke filluar nga fillimi i nëntorit, dhe për t'ju treguar se si po përgatitemi që t'ju mbështesim. E kuptojmë rëndësinë e transportit të besueshëm për arsimin e fëmijës suaj. Nëse shërbimi i autobusëve ndërpritet, përparësia jonë kryesore është të sigurohemi që çdo nxënës të mund të vazhdojë frekuentimin e shkollës pa ndërprerje.

Edhe pse Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut nuk kanë marrë drejtpërdrejt ndonjë njoftim zyrtar nga kompanitë e autobusëve për shkurtime nga puna, kuptojmë se kjo mund të ndodhë që në 3 nëntor 2025. Ne po e monitorojmë situatën nga afër dhe qëllimi ynë është të minimizojmë ndikimin e konsiderueshëm që kjo do të kishte te nxënësit dhe familjet. Rishikoni informacionin më poshtë dhe vazhdoni të vizitoni faqen tonë të internetit (schools.nyc.gov/transportation) për përditësime mbi zhvillimet dhe burimet më të fundit , pasi duam që të qëndroni të informuar për situatën dhe burimet e disponueshme.

- **Njoftime në rast të ndërprerjes së shërbimit të autobusit të verdhë:** Shkolla juaj do t'ju njoftojë nëse *ndodh* ndonjë ndërprerje në transportin me autobus dhe nëse do të ndikojë te fëmija juaj. Njoftimet do të dërgohen duke përdorur informacionin e kontaktit që i keni dhënë shkollës së fëmijës. Sigurohuni që informacioni të jetë i përditësuar në shkollë dhe në llogarinë tuaj të shkollave të NYC-së (NYCSA) (mësoni më shumë në schools.nyc.gov/NYCSA).
- **Burimet online të Shkollave Publike të Qytetit të Nju-Jorkut** Burimet që lidhen me transportin për familjet do të jenë të disponueshme në faqen tonë të internetit në adresën schools.nyc.gov/transportation. Këtu do të gjeni informacion mbi kartat OMNY, alternativat e transportit për nxënësit dhe familjet, procedurat e pjesëmarrjes dhe ndihmë tjetër të disponueshme derisa shërbimi i autobusëve të verdhë të rifillojë plotësisht. Vizitoni këtë faqe shpesh pasi ne do ta përditësojmë atë me informacionet më të fundit.
- **Përditësime në rrjetet sociale:** Ne gjithashtu do të ndajmë përditësime përmes llogarive tona në rrjetet sociale (@NYCSchools në [Facebook](https://www.facebook.com/NYCSchools), [Twitter](https://twitter.com/NYCSchools) dhe [Instagram](https://www.instagram.com/NYCSchools)).

- **Informacion shitesë:** Mund të telefononi në numrin 311 në çdo kohë për informacion dhe përditësimet më të fundit mbi shërbimin e autobusëve të verdhë.
- **Transporti alternativ në rast të një ndërprerjeje:** Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut po punojnë në mënyrë aktive për të organizuar transport alternativ për familjet që përdorin shërbimin e autobusëve të verdhë. Të gjitha familjet e prekura do të kenë mundësinë të marrin falas një kartë OMNY si për nxënësin ashtu edhe për kujdestarin e tij. Përveç kësaj, NYCPS do të ofrojë transport të parapaguar dhe do të ofrojë rimbursim aty ku është e nevojshme për nxënësit që kanë transport të rekomanduar në një Program Arsimor të Individualizuar (IEP) ose Plan Akomodimi 504 (504); nxënësit në strehim të përkohshëm ose kujdestari që marrin shërbim autobusi të verdhë dhe nxënësit me një përjashtim transporti të miratuar (schools.nyc.gov/transportationexceptions). Do të japim informacione shitesë në ditët në vijim. Koordinator i transportit të shkollës suaj do të punojë me ju për të ndihmuar familjen tuaj të marrë masat më të mira të mundshme për transportin për në shkollë dhe nga shkolla në rast të një ndërprerjeje.

Ne e dimë që shumë nga nxënësit dhe familjet tona varen nga shërbimi i autobusëve të verdhë dhe se edhe mundësia e një ndërprerjeje të shërbimit shkakton shqetësim, prandaj transparenca dhe mbështetja janë thelbësore për të përballuar këtë situatë. NYCPS po punon shumë drejt një zgjidhjeje dhe shpresojmë që këto plane për transport alternativ të jenë të panevojshme.

Ne jemi të përkushtuar t'ju mbështesim në të gjitha mënyrat e mundshme.

Me respekt,



Melissa Aviles-Ramos

Kancelare (Chancellor)